

THE COLLEGE BOARD

SAT[®] Test Directions Translated into ALBANIAN for Students Spring 2018 Testing Window Only

Notes to the Supervisor: This document should be printed and distributed once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book.

Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period.

Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and destroy it.

© 2018 The College Board. College Board and SAT are registered trademarks of the College Board. Unauthorized copying or reuse of any part of this document is illegal.

Pasqyra e lëndës

Shënime për studentin.....	3
1 Skenari SAT standard	4
1.1 Para se të fillojë provimi.....	4
1.2 Gjatë shpërndarjes së fletës së përgjigjeve	5
1.3 Gjatë shpërndarjes së librit të provimit	6
1.3.1 Udhëzimet e kapakut të parmë	9
1.3.2 Udhëzimet e kapakut të pasmë	10
1.4 Pjesa 1: Test i leximit.....	11
1.4.1 Gjatë pushimit.....	12
1.4.2 Pjesa 1 Udhëzime për librin e provimit.....	12
1.4.3 Deklarata e certifikimit	12
1.5 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës	12
1.5.1 Pjesa 2 Udhëzime për librin e provimit.....	13
1.6 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse	14
1.6.1 Gjatë pushimit.....	14
1.6.2 Pjesa 3 Udhëzime për librin e provimit.....	15
1.7 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse.....	17
1.7.1 Pjesa 4 Udhëzime për librin e provimit.....	18
1.7.2 Gjatë pushimit.....	20
1.8 Pjesa 5: Eseja SAT	20
1.8.1 Deklarata e fletës së përgjigjeve.....	21
1.8.2 Pjesa 5 Udhëzime për librin e esesë	21
2 Pas provimit	21
2.1 Gjatë mbledhjes së fletës së përgjigjeve.....	21
2.2 Para largimit të studentëve.....	22

Shënime për studentin

- Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve të cilat kontrollori do t'i lexojë me zë të lartë, si dhe i udhëzimeve me shkrim që gjenden në librin e provimit. Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përputhen fjalë për fjalë me atë çka lexohet nga kontrollori, sidoqoftë, informacioni në thelb është i njëjti. Nëse keni pyetje për atë që po lexohet nga kontrollori, ju lutem ngrini dorën.
- Mund ta mbani këtë dokument në bankën tuaj për të gjithë kohën e provimit, por duhet t'ia ktheni kontrollorit pas provimit.
- NUK lejohet ta përdorni këtë dokument për letër shënimesh.
- Në momente të ndryshme, kontrollori do të lajmërojë kohën e mbetur në pjesë, si edhe pushimet kur është e përshtatshme. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, këto lajmërime mund të ndryshojnë nga oraret dhe pushimet e renditura në këtë dokument të përkthyer. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.
- Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, kontrollori juaj mund t'ju japë udhëzime të mëtejshme në anglisht.
- Në këtë dokument janë përdorur ikona për të tërhequr vëmendjen tuaj tek informacione të caktuara:



Të dhëna të rëndësishme



Udhëzime të thëna nga kontrollori



Udhëzime që gjenden në librin e provimit

1 Skenari SAT standard

1.1 Para se të fillojë provimi

Kontrollori do të fillojë duke thënë:

- ▶ Mirëmëngjes. Sot do të bëni provimin SAT. Kjo është mundësia të tregoni sa të përgatitur jeni për kolegji dhe karrierë.

Nëse keni pyetje për ndonjë prej udhëzimeve që ju jap, ju lutem bëjini, në mënyrë që të siguroheni të jepni më të mirën tuaj. Nëse po përdorni udhëzime të shtypura që janë përkthyer, hapni tani broshurën për të më ndjekur ndërsa ju jap udhëzimet.

Në këtë dhomë, do të bëni provimin të cilin e kam vendosur në tabelë.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- ▶ College Board ka rregulla të cilat janë hartuar për t'i dhënë secilit prej jush mundësi të barabarta për të treguar aftësitë tuaja. Ne do t'ju përjashtojmë, dhe College Board do t'i bëjë të pavlefshme rezultatet e kujt do që përpiqet të fitojë avantazh të padrejtë kur:

- Jep ose merr ndihmë të çfarëdo lloji në provim
- Shikon në librin e provimit para se të fillojë provimi
- Punon në pjesën e gabuar ose kërkon në një pjesë të mëparshme ose të mëvonshme në librin e provimit ose fletën e përgjigjeve
- Përdor një makinë llogaritëse gjatë një pjese pa makinë llogaritëse
- Shënon përgjigje pasi ka mbaruar koha
- Ndan pyetjet ose përgjigjet e provimit me cilindo gjatë ose pas provimit
- Përdor mjete provimi të paautorizuara, përfshirë telefonat, gjatë provimit ose pushimeve
- Përpiqet të bëjë provimin në vend të dikujt tjetër

Gjithashtu mund të përjashtoheni nëse:

- Hani ose pini gjatë provimit (përveç nëse kjo është miratuar si lehtësi - përndryshe, ngrënia dhe pirja lejohen vetëm gjatë pushimeve)
- Shkaktoni shqetësime të çfarëdo lloji ose shpërqendrim për studentët e tjerë
- Shkoni te dollapi juaj ose largoheni nga ndërtesa gjatë pushimeve

Do të keni kohë deri në orën 11:59 të darkës me orën lindore në ditën e 4rt të javës nga momenti i mbarimit të provimit për të paraqitur një ankesë për ditën e provimit. Nëse shihni ndonjë lloj sjelljeje që shkakton shqetësime, ju lutem njoftoni kontrollorin e provimit, i cili do t'ju shpjegojë si të kontaktoni College Board. Ka ndonjë pyetje?

Nëse shkolla ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori juaj do të thotë:

- ▶ Në këtë moment duhet të keni dorëzuar të gjithë telefonat ose çdo pajisje tjetër elektronike. Nëse dikush ka ende pajisje elektronike të çfarëdo lloji, ju lutem çaktivizoni të gjitha alarmet, fikini dhe m'i dorëzoni mua tani. Të gjitha do t'ju kthehen në fund të provimit.

Nëse shkolla NUK ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Në këtë moment, nëse keni me vete telefon ose çfarëdo pajisjeje tjetër elektronike, duhet të çaktivizoni çdo alarm, ta fikni komplet dhe ta lini mënjanë poshtë bankës derisa të mbarojë provimi. Çdo pajisje elektronike që nuk është fikur dhe lënë mënjanë mund të merret dhe t'i kontrollohet përmbajtja si pjesë e një hetimi të hollësishëm.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Tani do të përgatitemi për të filluar provimin.
 - Hiqni çdo gjë nga banka përveç lapsave dhe makinës llogaritëse të pranueshme.
 - Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, nxirrini dhe lërinë në dysHEME poshtë bankës.
 - Vendosni poshtë bankës çdo shishe uji dhe ushqimet. Mbyllini të gjitha çantat e dorës ose të shpinës dhe vendosini poshtë bankës derisa të mbarojë provimi.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Tani do të shikoj rreth e qark për një moment për t'u siguruar nëse po përdorni makina llogaritëse të aprovuara.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Nuk lejohet t'i ndani ose shkëmbeni makinat llogaritëse në asnjë moment. Vendoseni makinën llogaritëse poshtë bankës tani. Nuk do t'ju duhet deri në një pjesë të mëvonshme.

1.2 Gjatë shpërndarjes së fletës së përgjigjeve

Pas shpërndarjes së fletëve të përgjigjeve, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Këto janë fletët e përgjigjeve që do t'i përdorni për të shënuar përgjigjet tuaja në provim. Ju lutem kontrolloni për t'u siguruar që në fletën e përgjigjeve të jetë emri juaj zyrtar i saktë. Ngrini dorën nëse keni marrë fletën e gabuar të përgjigjeve.

Nëse të gjithë i kanë plotësuar fushat e kërkuara, kontrollori do të kalojë tek «Gjatë shpërndarjes së librit të provimit.» Nëse ju ose studentët e tjerë duhet të plotësojnë fushat e kërkuara në fletën e përgjigjeve, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Shënoni emrin tuaj të plotë zyrtar në kutinë 1 tani. Nëse fleta e përgjigjeve ka një etiketë, ju lutem kontrolloni që në tuajën ndodhet emri juaj zyrtar i saktë. Nëse gjeni ndonjë gabim, ngrini dorën dhe do t'ju jap një fletë përgjigjesh tjetër.

Për kutitë 2 dhe 3, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Gjeni kutinë 2. Ngrini dorën nëse nuk jeni student në këtë shkollë, dhe unë do të vij dhe do t'ju ndihmoj t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Të gjithë të tjerët, mbushni flluskën për «Po,» dhe pastaj printoni emrin e shkollës, qytetit dhe shtetit tonë. Mund ta lini vijën e shtetit bosh. Ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Në kutinë 3, printoni kodin me 6 shifra të shkollës _____ dhe mbushni flluskat përkatëse. Ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Nëse bëni shkollën në shtëpi, kontrollori do t'ju thotë të mbushni flluskën për «Jo, bëj shkollën në shtëpi» dhe shkruani «970000» në kutinë 3.

Për kutinë 4, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Mos bëni shënime në kutinë 4, “Kod opsional.”

Për kutinë 5, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Plotësoni të 3 pjesët e datëlindjes suaj. Çdo fushë me 2 shifra duhet të fillojë me 0 nëse numri është më pak se 10. Sigurohuni të përfshini flluskën për 2 shifrat e para të vitit kur keni lindur. Ngrini dorën nëse keni pyetje.

Për kutitë 6-10, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Kaloni në faqen 2 dhe plotësoni adresat tuaja në kutitë 6 deri 9. Lëreni kutinë 10 bosh. Ngrini dorën nëse keni pyetje. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Për kutinë 12, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Kaloni në faqen 2 (ose faqen 5 të fletës së përgjigjeve të zmadhuara). Mbushni flluskën për notën tuaj aktuale në kutinë 12.

Për kutinë 15, kontrollorijuaq do të thotë:

- 🔊 Gjeni kutinë 15 në faqen 3 (ose faqen 6 të fletës së përgjigjeve të zmadhuara). Shënoni flluskën e duhur në kutinë 15.

Për kutinë 23, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Tani kaloni në kutinë 23. Në kutinë 23, mbushni flluskën me emër «Numri i identifikimit të studentit,» pastaj printoni dhe vendosni numrin e identifikimit të studentit duke filluar me kolonën e parë në të majtë. Mund të gjeni numrin e identifikimit të studentit në cepin e majtë të sipërm të etiketës. Nëse ka shkronja në numrin e identifikimit tuaj, kapërcejini dhe vendosni vetëm numrat. Nëse nuk e dini numrin tuaj të identifikimit të studentit, ju lutem ngrini dorën. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

1.3 Gjatë shpërndarjes së librit të provimit

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Tani do të shpërndaj librat e provimit. MOS i hapni derisa t'ju them unë.

Shikoni «Udhëzimet në kapakun e parmë» në fund të kësaj pjese për një përkthim të kapakut të parmë.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Kontrolloni për të parë që fleta e përgjigjeve dhe libri i provimit janë për versionin e SAT që kam renditur në tabelë, SAT ose SAT me ese.

Kur të merrni librin e provimit, kthejeni dhe lexoni kapakun e pasmë. Ka të dhëna të rëndësishme për oraret, shënimin e përgjigjeve dhe rezultatet.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Kur të keni mbaruar së lexuari, ju lutem ngrini kokën.

A keni pyetje për ato që sapo lexuat?

Pasi t'u jetë dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Udhëzimet e mëposhtme janë tepër të rëndësishme për rezultatet e provimit tuaj. Nëse nuk i ndiqni saktë udhëzimet e mia, mund të mos merrni rezultat. Dëgjoni me kujdes.

Sigurohuni që të përdorni laps nr. 2 dhe që të mbushni flluskat me ngjyrë të errët dhe plotësisht në fletën e përgjigjeve. Nëse e ndryshoni përgjigjen, fshijeni sa më shumë të jetë e mundur. Mos bëni shkarravina dhe mos e përdorni fletën e përgjigjeve për shënime personale.

Nëse po përdorni fletë përgjigjesh të zmadhuara, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Nëse po përdorni fletë përgjigjesh të zmadhuara, lexoni gjithashtu udhëzimet përpara fletës së përgjigjeve se ku dhe si të shënoni përgjigjet tuaja. Do të shënoni një «X» në çdo katror përkatës në vend që të mbushni flluskat, dhe numrat e faqeve do të ndryshojnë nga ato që lajmëroj unë.

Shikoni «Udhëzimet për kapakun e pasmë» në fund të kësaj pjese për një përkthim të kapakut të pasmë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Mbrapa librit të provimit, printoni mbiemrin, emrin, dhe inicialin e emrit të mesëm, nëse keni.

Pastaj printoni numrin e kodit të shkollës, emrin e shkollës dhe numrin e kësaj dhome (ose emrin).

Për fushën e kodit të formularit, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Në kapakun e pasmë të librit të provimit, gjeni kutinë me emër «44-Kodi i formularit». Kopjoni shkronjat dhe numrat në kutinë 44 të fletës së përgjigjeve saktësisht siç tregohet mbrapa fletores së provimit dhe mbushni flluskat.

Për fushën e identifikimit të provimit, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Tani, gjeni kutinë me emër «45-Identifikimi i provimit.» Kopjoni numrin në fletën e përgjigjeve në kutinë 45.

Për fushën e numrit të serisë së librit të provimit, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Shikoni në kapakun përpara të librit të provimit. Gjeni numrin në cepin e djathtë të sipërm të librit të provimit me emër «Numri i serisë së librit të provimit» dhe vendoseni në kutinë 46 në fletën e përgjigjeve. Mbushni flluskat përkatëse.

Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Merrni një moment për t'u siguruar që fushat Kodi i formularit, Identifikimi i provimit dhe Numri i serisë së librit të provimit janë plotësuar saktë. Është e domosdoshme që të vendosni kodet e sakta në fletën e përgjigjeve. Përndryshe, mund të mos merrni rezultatet.

Për kodin e dhomës së provimit, kontrollori mund të thotë:

- 🔊 Në kutinë 47 në fletën e përgjigjeve, plotësoni kodin e dhomës së provimit me 3 shifra që kam postuar për ju.

OSE

Për kodin e dhomës së provimit, kontrollori juaj mund të thotë:

- 🔊 Lëreni kutinë 47 bosh në fletën e përgjigjeve.

Përveç nëse po bëni provimin me lehtësira të lejuara nga shteti, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Tani dëgjoni këtë informacion të rëndësishëm. Nëse doni të anuloni rezultatet tuaja para se të largoheni, më kërkoni një formular kërkesë për të anuluar rezultatet e provimit, të cilin duhet ta plotësoni para se të largoheni nga dhoma. Për të anuluar rezultatet tuaja më vonë, duhet të njoftoni College Board me shkrim jo më vonë se ora 11:59 e mbrëmjes me orën lindore në ditën e 4rt të javës duke filluar nga sot.

Dërgoni kërkesën e firmosur të anulimit me postë brenda një dite ose me faks. Nuk mundeni t'i anuloni rezultatet me një mesazh email ose telefon.

Nëse i anuloni rezultatet tuaja, ato përsëri do t'i dërgohen shtetit dhe rrethit, si edhe do të jenë në dispozicion për shkollën tuaj, por NUK do t'u dërgohen kolegjeve ose organizatave shkollore që keni zgjedhur, ose nuk do të jenë në dispozicion në sistemin e raportimit të College Board.

Për të gjithë studentët, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër. Mund ta përdorni librin e provimit për shënime, por përgjigjet duhet t'i shënoni në fletën e përgjigjeve, përveç nëse aprovoheni t'i shënoni në librin e provimit. Pasi të jetë njoftuar mbarimi i kohës, nuk mundeni t'i kaloni përgjigjet nga libri i provimit në fletën e përgjigjeve ose të mbushni flluskat bosh.

Gjatë provimit, mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit shtrirë në mes të bankës. Nëse gjeni ndonjë gabim me fletën e përgjigjeve ose librin e provimit, si për shembull mungesën e një faqeje, ose nëse shikoni se keni shkruar përgjigjet në pjesën e gabuar të fletës së përgjigjeve, ngrini dorën.

Së fundi, fletët e përgjigjeve dhe librat e provimit nuk duhet të hiqen asnjëherë nga dhoma e provimit.

Unë do të sillem nëpër dhomë për të kontrolluar ecurinë tuaj. Unë do të mbaj gjithashtu orën zyrtare për provimin. Do të keni pushime gjatë provimit, kur mund të largoheni nga kjo dhomë për të ngrënë diçka ose për të përdorur banjën.

Mos harroni, pasi të ketë mbaruar provimi, askush nuk mund të largohet nga dhoma derisa t'ju jap leje. Nëse keni pyetje rreth procedurave të provimit, ju lutem bëjini tani. Nuk mund t'i përgjigjem pyetjeve gjatë pjesëve me kohë të provimit.

1.3.1 Udhëzimet e kapakut të parmë



Më poshtë keni një përkthim të kapakut të parmë të librit të provimit.

PËRKUJTUES TË RËNDËSISHËM

1. Kërkohet një laps nr. 2 për provimin. Mos përdorni laps mekanik (portaminë) ose stilolaps.
2. Ndarja e pyetjeve me cilindo është shkelje e politikave për sigurinë dhe drejtësinë e provimit dhe mund të bëjë që rezultatet tuaja të anulohen.

KY LIBËR PROVIMI NUK DUHET TË MERRET JASHTË DHOMËS. NDALOHET RIPRODHIMI OSE PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I ÇFARËDO PJESE TË KËTIJ LIBRI PROVIMI.

© 2018 The College Board. College Board dhe logoja e lendes janë marka tregtare të regjistruara të College Board.

1.4 Pjesa 1: Test i leximit

⚠️ **Koha standarde për pjesën 1 është 65 minuta, me një pushim prej 10 minutash në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.**

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Pasi të fillojmë, do të keni 65 minuta kohë për të punuar me pjesën 1, testin e leximit. Do të bëjmë një pushim të shkurtër kur të mbarojë kjo pjesë. Ju lutem mbani makinën llogaritëse poshtë bankës; nuk do t'ju duhet për këtë pjesë.

Sigurohuni të përdorni një laps numër 2 dhe që të mbushni të gjithë flluskën me ngjyrë të errët dhe plotësisht. Nëse e ndryshoni përgjigjen, fshijeni sa më shumë të jetë e mundur. Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Mos harroni se merrni pikë për përgjigjet e sakta por nuk humbisni pikë për përgjigjet e gabuara. Kjo do të thotë se duhet të përpiqeni t'i përgjigjeni çdo pyetje edhe nëse nuk jeni i sigurt për përgjigjen e saktë.

Ju lutem, gjeni pjesën 1 në fletën e përgjigjeve. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 1. Tani, hapni librin e provimit në pjesën 1, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani. Suksese.

Pas 30 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Keni 35 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 60 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 65 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ndaloni punën dhe vendosni lapsin poshtë. Mbyllni fletën e përgjigjeve dhe vendoseni brenda kapakut të parmë të librit të provimit. Mbylleni librin e provimit dhe lëreni mbi bankë. Tani do të bëjmë një pushim për 10 minuta.

Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Tregoni konsideratë për ata që janë në dhomat e tjera.

Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 10 minutash.

Nëse shkolla NUK i ka mbledhur sendet tuaja personale, kontrollori do të thotë:


- 🔊 Nuk lejohet të përdorni telefon ose asnjë pajisje tjetër elektronike në këtë pushim ose në asnjë pushim tjetër gjatë provimit. Çdo telefon ose pajisje tjetër duhet të qëndrojë e fikur dhe të lihet larg poshtë bankës.

1.4.1 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:

 Ju lutem uluni.

1.4.2 Pjesa 1 Udhëzime për librin e provimit

 *Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 1 të librit të provimit.*

65 MINUTA, 52 PYETJE (KOHA STANDARDE)


Shkoni te pjesa 1 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

UDHËZIME


Pas çdo fragmenti ose çifti fragmentesh më poshtë ka një numër pyetjesh. Pasi të keni lexuar çdo fragment ose çift fragmentesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për t'iu përgjigjur pyetjes duke u bazuar në atë çka është thënë ose nënkuptuar në fragment ose fragmente dhe në çdo grafik të shoqëruar (si tabelë ose diagram).

1.4.3 Deklarata e certifikimit

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:


 Kur të jepni fletën e përgjigjeve tuaja, ju pranoni se, në asnjë rrethanë, nuk do të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk do t'ia jepni askujt, ose nuk do t'i diskutoni me asnjë lloj forme, përfshirë por jo vetëm, me email, mesazhe ose internet. Këto kushte janë shpjeguar me hollësi tek Udhëzuesi i Studentëve për Ditën Shkollore SAT dhe në internet në sat.org.

Nxirrni fletën e përgjigjeve, por lëreni librin e provimit të mbyllur. Kaloni në faqen e pasme të fletës së përgjigjeve dhe gjeni kutinë 48, Deklarata e certifikimit. Pasi të keni lexuar paragrafin e termave në fund, kopjoni deklaratën me shkrimin tuaj të zakonshëm - shkronjat e shtypit ose kursive janë të pranueshme gjithashtu. Pastaj shkruani emrin tuaj të plotë siç do të bënit në një dokument zyrtar. Pas firmës suaj, vendosni datën e sotme. Ngrini kokën kur të keni mbaruar.

 *Më poshtë keni një përkthim të deklaratës së certifikimit në kutinë 48 të fletës së përgjigjeve. Kopjoni deklaratën në anglisht, jo përkthimin e dhënë këtu.*

Sot, po hedh një hap drejt rrugës për në kolegji. Konfirmoj se unë jam personi i renditur në fletën e përgjigjeve dhe zotohem të ndjek politikën për sigurinë dhe drejtësinë e provimit siç përshkruhet në udhëzimet e provimit.

1.5 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës

 **Koha standarde për pjesën 2 është 35 minuta.** Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Pasi të fillojmë, do të keni 35 minuta kohë të punoni me pjesën 2, testin e shkrimit dhe gjuhës. Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër. Ju lutem mbani makinën llogaritëse poshtë bankës; nuk do t'ju duhet për këtë pjesë.

Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë.

Tani, gjeni pjesën 2 në fletën e përgjigjeve. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 2. Hapni librin e provimit në pjesën 2, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 15 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Keni 20 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 30 minutash, kontrollori do të thotë:


- 🔊 Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 35 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ndaloni punën dhe vendosni lapsin poshtë.

Vendosni fletën e përgjigjeve tuaja mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar punën. Mbylleni librin e provimit.

1.5.1 Pjesa 2 Udhëzime për librin e provimit

 *Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 2 të librit të provimit.*

35 MINUTA, 44 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 2 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Çdo fragment më poshtë shoqërohet nga një numër pyetjesh. Për disa pyetje, do të mendoni si mund të ndryshohet fragmenti për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetje të tjera, do të mendoni si mund të redaktohet fragmenti për të korrigjuar gabimet në strukturën, përdorimin ose shenjat e pikësimit të fjalive. Një fragment ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose më shumë grafikë (si për shembull tabelë ose diagram) të cilat do t'i shqyrtoni kur të merrni vendime për ndryshime dhe redaktime.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një fragmenti. Pyetje të tjera do t'ju drejtojnë në një vend në fragment ose do t'ju kërkojnë të mendoheni për të gjithë fragmentin.


Pasi leximit të çdo fragmenti, zgjidhni atë përgjigje të pyetjes që përmirëson më mirë nga gjithë të tjerat cilësinë e shkrimit në fragment, ose që e bën fragmentin të përputhet me rregullat e gjuhës angleze të shkruar standarde. Shumë pyetje mund të kenë një opsion «ASNJË NDRYSHIM». Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se zgjedhja më e mirë është ta lini siç është pjesën përkatëse të fragmentit.

1.6 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse

 **Koha standarde për pjesën 3 është 25 minuta, me një pushim prej 5 minutash në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem, dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.**

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:

 Pasi të fillojmë, do të keni 25 minuta kohë të punoni me pjesën 3, testin e matematikës pa makinë llogaritëse. Do të bëjmë një pushim të shkurtër kur të ketë mbaruar kjo pjesë.


Megjithëse kjo është një pjesë matematike, NUK lejohet të përdorni makinë llogaritëse në këtë pjesë të provimit dhe makinën llogaritëse duhet ta mbani poshtë bankës përveç nëse keni një lehtësi të miratuar për të përdorur një makinë llogaritëse me 4 funksione.

Në librin e provimit gjenden udhëzime se si të vendosni përgjigjen tuaj në pyetjet e emërtuara «Përgjigjet e bëra nga studenti». Këto përgjigje të bëra nga studenti mund të jenë më të shkurtra, por jo më të gjata se 4 karaktere. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 3.


Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Ju lutem hapni librin e provimit dhe nxirrni fletën e përgjigjeve. Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë. Gjeni pjesën 3 në fletën e përgjigjeve. Tani, kaloni në pjesën 3 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.


Pas 10 minutash, kontrollori do të thotë:

 Keni 15 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 20 minutash, kontrollori do të thotë:

 Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 25 minutash, kontrollori do të thotë:

 Ndaloni punën dhe vendosni lapsin poshtë.


Vendosni fletën e përgjigjeve tuaja mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar punën. Mbylleni librin e provimit dhe lëreni mbi bankë. Tani do të bëjmë një pushim për 5 minuta. Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Njëlloj si më parë, mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 5 minutash.

1.6.1 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:

 Ju lutem uluni.

1.6.2 Pjesa 3 Udhëzime për librin e provimit

 Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 3 të librit të provimit.

25 MINUTA, 20 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Shkoni te pjesa 3 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Për pyetjet 1-15, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni rrethin përkatës në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 16 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.

SHËNIME


1. Nuk lejohet përdorimi i një makine llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.

REFERENCË




$$A = \pi r^2$$


$$C = 2\pi r$$




$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndësja
kënddrejtë të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

UDHËZIME

Për pyetjet 16–20, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë, siç tregohet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

- Megjithëse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t’ju ndihmuar të mbushni rrathët saktë. Do merrni pikë vetëm nëse rrathët janë mbushur saktë.
- Shënoni jo më shumë se një rreth në çdo kolonë.
- Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
- Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.

- Numrat e përzierë** të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të shënohen si

3	1	/	2
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○

3.5 ose 7/2. (Nëse vendoset $\frac{31}{2}$ në tabelë, do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo si $3\frac{1}{2}$.)

- Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

Përgjigja: $\frac{7}{12}$

	7	/	1	2
	○	○	○	○
	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○

Shkruani përgjigjen në kuti.

Vendosni rezultatin në tabelë.

Përgjigja: 2.5

	2	.	5
	○	○	○
	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○

Vija e thyesës

Pika dhjetore

Mënyrat e pranueshme për të vendosur në tabelë $\frac{2}{3}$ janë:

	2	/	3
	○	○	○
	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○

	.	6	6	6
	○	○	○	○
	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○

	.	6	6	7
	○	○	○	○
	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○
○	○	○	○	○


Përgjigja: 201 - secili pozicion është i saktë

	2	0	1
	○	○	○
	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○

	2	0	1
	○	○	○
	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○
○	○	○	○


SHËNIM: Mund t'i filloni përgjigjet tuaja në cilëndo kolonë nëse jua lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet të lihen bosh.

1.7 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse

 **Koha standarde për pjesën 4 është 55 minuta.** Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:

 Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta kohë të punoni me pjesën 4, testin e matematikës me makinë llogaritëse.

Mund të përdorni një makinë llogaritëse për këtë pjesë. Ju lutem nxirrni makinën llogaritëse tani dhe vendoseni në mes të bankës.

Kur të përdorni makinën llogaritëse, ndiqni këto udhëzime:


- Mbajeni mbi bankë ose mbajeni në mënyrë të tillë që studentët e tjerë të mos shohin dot punën tuaj.
- Mos e ndani ose mos e shkëmbeni makinën llogaritëse.
- Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, mbajini në dysheme poshtë bankës tuaj.
- Nëse makina juaj llogaritëse priset dhe keni bateri ose makinë llogaritëse rezervë, ngrini dorën. Do të shikoj nëse mjeti juaj zëvendës është i pranueshëm. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni me provimin. Të gjitha pyetjet e matematikës mund t'ju jepet përgjigje edhe pa makinë llogaritëse.

Në librin e provimit gjenden udhëzime se si të vendosni përgjigjen tuaj në pyetjet e emërtuara «Përgjigjet e bëra nga studenti». Këto përgjigje të bëra nga studenti mund të jenë më të shkurtra, por jo më të gjata se 4 karaktere. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 4.


Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Ju lutem hapni librin e provimit dhe nxirrni fletën e përgjigjeve. Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë. Gjeni pjesën 4 në fletën e përgjigjeve. Tani, kaloni në pjesën 4 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.


Pas 25 minutash, kontrollori do të thotë:

 Keni 30 minuta të mbetura në këtë pjesë.


Pas 50 minutash, kontrollori do të thotë:

 Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 55 minutash, kontrollori do të thotë:

 Ndaloni punën dhe vendosni lapsin poshtë. Mbylleni librin e provimit dhe fletën e përgjigjeve. Vendoseni fletën e përgjigjeve ngjitur me librin e provimit.

1.7.1 Pjesa 4 Udhëzime për librin e provimit

 Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 4 të librit të provimit.

55 MINUTA, 38 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Shkoni te pjesa 4 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Për pyetjet 1-30, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni rrethin përkatës në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 22 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.

SHËNIME


1. Lejohet përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.

REFERENCË




$$A = \pi r^2$$


$$C = 2\pi r$$





$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$



$$c^2 = a^2 + b^2$$



$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

1.7.2 Gjatë pushimit

Nëse po bëni SAT pa ese, kontrollori do të kalojë në «Pas provimit.»

Nëse po bëni SAT me ese, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Vendoseni makinën llogaritëse poshtë bankës. Tani do të bëjmë një pushim për t'u çlodhur për 2 minuta. Nuk lejohet të largoheni nga dhoma apo të diskutoni pyetjet e provimit.

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ju lutem, uluni. Tani do të mbledh librat e provimit. Duhet ta mbani fletën e përgjigjeve për pjesën e esesë të këtij testi. Ju lutem rrini ulur me qetësi ndërsa mbledh dhe numëroj librat e provimit.

1.8 Pjesa 5: Eseja SAT



*Koha standarde për pjesën 5 është **50 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.*

Një përkthim i deklaratës për përdorimin e esesë suaj (në fletën e përgjigjeve) dhe i udhëzimeve të librit të esesë shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Për studentët që bëjnë SAT me ese, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Hapni fletën e përgjigjeve në fillim të pjesës 5 në faqen 6 (ose faqen 34 në fletën e përgjigjeve në bllok të madh). Kushtojini një moment leximit të deklaratës për përdorimin e esesë suaj, pastaj vendosni nëse doni të shënoni ose jo flluskën (ose katrorin). Kur të keni mbaruar, ju lutem ngrini kokën.

Tani do t'i jap një libër eseje secilit prej jush. Mos e hapni librin e esesë derisa t'ju them unë.

Kur të gjithë studentët të kenë një libër eseje, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Mbrapa librit të esesë, printoni mbiemrin, emrin dhe inicialin e emrit të mesëm, nëse keni. Pastaj printoni numrin e kodit të shkollës, _____ emrin e shkollës _____, dhe numrin e kësaj dhome (ose emrin) _____.

Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta kohë të punoni me pjesën 5, Eseja SAT. Mund të mbani shënime dhe të planifikoni esenë tuaj në faqen e planifikimit pa vija, por çdo gjë e shkruar aty nuk do të merret parasysh për rezultatin. Kur të jeni gati, do të duhet të filloni të shkruani esenë tuaj në faqen e parë me vija në të cilën thuhet «Filloni esenë tuaj këtu.» Duhet të shkruani esenë tuaj në faqet përkatëse të fletës së përgjigjeve dhe brenda kufijve të shënuar. Mos vazhdoni të shkruani pas fjalës «NDAL» në faqen e fundit me vija, sepse asgjë gjë e shkruar pas asaj pike nuk do të merret parasysh për rezultatin. Nuk lejohen faqe shtesë. Esenë tuaj duhet ta shkruani duke përdorur një laps numër 2. Nëse nuk përdorni laps numër 2, eseja juaj do të duket bosh. Nëse e lini esenë bosh, do të merrni rezultat 0 për esenë.

Pasi t'u jetë dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Lexoni udhëzimet në kapakun e librit të esesë dhe pastaj hapni librin e esesë dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 25 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Keni 25 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 45 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 50 minutash, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ndaloni punën dhe vendosni lapsin poshtë. Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe librin e esesë. Vendoseni fletën e përgjigjeve pas librit të esesë.

1.8.1 Deklarata e fletës së përgjigjeve

📖 *Më poshtë keni një përkthim të deklaratës për përdorimin e esesë suaj në faqen e planifikimit të fletës së përgjigjeve tuaja.*

E kuptoj se eseja ime (pa emrin tim) mund të riprodhohet në materiale të tjera të College Board. Nëse e shënoj këtë ovale, nuk jap lejen për të riprodhuar esenë time për asnjë qëllim tjetër përtej raportimit të rezultatit dhe vlerësimit të aftësive të mia në shkrim. Shënimi i kësaj ovaleje nuk do të ketë asnjë ndikim në rezultatin tim, as nuk do të pengojë që eseja ime të vihet në dispozicion për cilindo koleg të cilit i dërgoj rezultatet e mia SAT.

1.8.2 Pjesa 5 Udhëzime për librin e esesë

📖 *Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në kapakun e parme të librit të esesë.*

Eseja ju jep mundësinë të tregoni sa mirë mund të lexoni dhe kuptoni një fragment dhe të shkruani një ese duke analizuar fragmentin. Në esenë tuaj, duhet të tregoni se e keni lexuar fragmentin me kujdes, të bëni një analizë të qartë dhe logjike, dhe të përdorni gjuhën me saktësi.

Keni 50 minuta kohë për të lexuar fragmentin dhe për të shkruar një ese në përgjigje të kërkesës që gjendet brenda kësaj broshure.

2 Pas provimit

Për të gjithë studentët, kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Urime, sapo mbaruat provimin! Para se të mbledh materialet tuaja të provimit, ju lutem ktheni mbrapsh fletën e përgjigjeve dhe kontrolloni nëse keni plotësuar kodin e formularit në kutinë 44. Ky kod formulari është i nevojshëm për nxjerrjen e rezultatit të provimit tuaj. Ju lutem ngrini dorën nëse keni nevojë për ndihmë për të plotësuar kutinë.

Pastaj kontrollori juaj do të thotë:

- 🔊 Tani do të mbledh materialet e provimit tuaj. Ju lutem rrini ulur me qetësi derisa t'ju lë të lirë.

2.1 Gjatë mbledhjes së fletës së përgjigjeve

Nëse keni plotësuar të dhënat personale në fletën e përgjigjeve, kontrollori do t'ju marrë fletën e përgjigjeve dhe do të kalojë në «Para largimit të studentëve.»

Nëse nuk i keni plotësuar të dhënat personale në fletën e përgjigjeve, kontrollori mund t'ju kërkojë të rrini ulur me qetësi ndërkohë që studentët e tjerë largohen.

Kur të jeni gati, kontrollori juaj do të thotë:

- ☞ Si pjesë e ditës shkollore SAT, tani do të keni mundësinë t'u përgjigjeni disa pyetjeve për veten tuaj dhe për planet tuaja për kolegji, si edhe të zgjidhni deri në 4 vende ose programe ku mund të dërgoni rezultatet.

Për kutinë 11, kontrollori do të thotë:

- ☞ Kutia 11 ju kërkon numrin e celularit të SHBA-së. Pranoen vetëm numrat celularë të SHBA-së. Duke dhënë numrin tuaj, ju pranoni të merrni mesazhe nga College Board rreth SAT, të merrni pjesë në sondazhe studimore, dhe të merrni informacione falas mbi shërbimet e planifikimit për kolegji. Zbatohen tarifat standarde për mesazhet tekst. Mund të zgjidhni të përjashtoheni në çfarëdo kohe. College Board nuk do të ndajë numrin tuaj të telefonit me organizata të tjera.

Nëse i pranoni këto rregulla, vendosni numrin tuaj të telefonit. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Për kutinë 13, kontrollori do të thotë:

- ☞ Kaloni në faqen 3. Nëse doni të merrni informacione nga College Board me email, përfshirë këtu të dhëna mbi rezultatet tuaja pasi ato të vihen në dispozicion në internet, shkruani adresën tuaj të email-it dhe plotësoni flluskat përkatëse në kutinë 13. Tregoni sipër kutisë nëse kjo është adresa juaj e email-it apo adresa e prindit ose kujdestarit. Nëse jepni adresën tuaj të email-it (jo të një prindi ose kujdestari) dhe pranoni shërbimin e kërkimit të studentit në fund të kësaj seance, mund të merrni në adresën tuaj të email-it informacione nga kolegjet. Do t'ju tregoj më shumë për shërbimin e kërkimit të studentit për pak minuta. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Për kutinë 14, kontrollori do të thotë:

- ☞ Në kutinë 14, plotësoni flluskën për muajin që prisni të diplomoheni nga shkolla e mesme. Pastaj printoni 2 shifrat për vitin e diplomimit në kuti dhe mbushni flluskat përkatëse.

Kontrollori do t'ju kërkojë të përdorni Udhëzime për fletën e përgjigjeve të studentit për të plotësuar të dhënat e mbetura në fletën e përgjigjeve. Kur të kenë mbaruar të gjithë, kontrollori do të marrë fletën e përgjigjeve dhe do të vazhdojë me «Para largimit të studentëve.»

2.2 Para largimit të studentëve

Kur të jenë marrë të gjitha materialet e studentëve, kontrollori do të thotë:

- ☞ Mos harroni, në asnjë rrethanë nuk duhet të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk duhet t'ia jepni dikujt tjetër, apo t'i diskutoni me dikë tjetër me çfarëdo forme, duke përfshirë email, mesazhe, ose internet.

Nëse jeni në dhomën SAT me ese, kontrollori do të thotë:

- ☞ Përveç kësaj, nuk ju lejohet të diskutoni ose ndani pyetjen e esesë së sotme derisa eseja të jenë në dispozicion në internet.

Nëse shkolla juaj ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Ndërsa përgatiteni për t'u larguar, ju lutem afrohuni dhe merrni sendet personale që ju mora më parë. Pasi të keni marrë të gjitha sendet tuaja, mund të dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

OSE

Nëse shkolla juaj NUK ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:

- 🔊 Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Merrni sendet tuaja dhe dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.